

Nr.2716/1..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 14.06. 2022

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Znj.

Sekretar i Përgjithshëm

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

(Rr. "Abdi Toptani" Nr. 1, 1001, Tiranë)

E nderuar **Znj.**

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 3948/1 Prot, dt. 06.06.2022, me objekt "Dërgohet për trajtim kërkesa për informacion e znj. i", hyrë në KESH sh.a me nr.2716, datë 07.07.2022, Ju informojmë si më poshtë:

Pyetja 1: Në cilën fazë ndodhet studimi i fizibilitetit të HEC Skavica?

Përgjigje: Në zbatim të parashikimeve të ligjit Nr. 38/2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International, Inc.", për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës" (në vijim "Ligji 38/2021") dhe VKM nr.485, datë 30.7.2021 "Për miratimin e kontratës së fazës së parë "kontratë për shërbime teknike - projekti Hidroenergjetik i Skavicës" ndërmjet KESH SHA dhe Bechtel Limited", shoqëria Bechtel Limited (në vijim "Bechtel") është duke zhvilluar fazën e parë të projektit për ndërtimin e HEC Skavica. Referuar parashikimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit 38/2021 shoqëria Bechtel është në proces realizimi të veprimtarive të mëposhtme:

- a) matje topografike dhe studime hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit;
- b) studime dhe inspektime gjeoteknike në terren;
- c) zhvillimin e strategjisë për realizimin e projektit;
- d) rishikimin dhe finalizimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor e social;
- e) përgatitjen e projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventimin e kostove dhe të sasive; dhe shërbime të tjera të dakordësuara për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës. Alternativat për vendndodhjen e digës dhe elementeve të tjera të Projektit;
- f) llojin dhe lartësinë e digës;
- g) korridorin e linjës së transmetimit;
- h) rrugët hyrëse dhe facilitetet e përkohshme;

- i) vlerësimet gjeologjike, gjeoteknike, hidrologjike, të ndryshimit të klimës dhe përmbytjeve;
- j) studimet për fuqinë dhe prodhimin e energjisë;
- k) tunelet për skemën hidrike.

Aktualisht janë duke u shqyrtuar dy alternativa të mundshme të pozicionimit të Digës dhe vendimi për alternativën më fizibël pritet të merret në tremujorin e tretë të vitit 2022. Me përzgjedhjen e alternativës në fjalë do të nisë edhe puna për projektin paraprak, një punë që do të përfundojë me vlerësimin e kostove dhe të planit të zbatimit.

Siç u tha edhe më lart nuk ka një vendim përfundimtar mbi treguesit teknik të projektit. Nga kontraktori po mblidhen dhe vlerësohen të gjitha informacionet e nevojshme për realizimin e procesit të përzgjedhjes së alternativës më fizibël.

Në punën e saj për realizimin e fazës së parë të projektit Bechtel mbështetet nga kompani ndërkombëtare si Mott MacDonald (për pjesën inxhinierike) dhe Golder (për ndikimin mjedisor dhe social (VNMS)).

Pyetja 2: *A është bërë konsultim paraprak me publikun, dhe cila është praktika e ndjekur?*

Përgjigje: KESH, Bechtel e partnerët e tjerë të projektit janë të angazhuar të trajtojnë në mënyrë të drejtë banorët dhe komunitetet që preken nga projekti. Vëzhgimi social në terren, i vijueshëm përgjatë gjithë fazës së studimit, është një nga shumë mundësitë për të marrë informacion dhe opinionin e banorëve. Përgatitja e VNMS-së është proces që shoqërohet në mënyrë të vazhdueshme me vëzhgime në terren si dhe me komunikim të ngushtë me palët e interesit përfshirë këtu edhe komunitetet potencialisht të prekshme nga projekti si edhe autoritetet vendore e qendrore. Projekti do të ketë angazhime të vazhdueshme me komunitetet e prekura dhe palët e interesit përgjatë gjithë procesit të përgatitjes së raportit të VNMS-së. Gjithashtu, bazuar edhe në kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, raporti i VNMS-së do të ndahet me komunitetet nëpërmjet dëgjësave të hapura publike përpara së të paraqitet për aprovim nga autoritetet. Opinione dhe komentet e marra nga publiku do të bëhen pjesë e raportit përfundimtar të VNMS-së.

Pyetja 3: *Cilat janë rezultatet e impaktit mjedisor dhe impaktit social të ndërtimit të HEC Skavicës?*

Përgjigje: Në këtë fazë të projektit disa ekipe të ndryshme kanë vizituar zonat që do të preken nga projekti dhe kanë bërë mbledhjen e informacionit për qëllime të hartimit të një raporti final vlerësimi. Objektivi i aktiviteteve të tyre është mbledhja në terren e të dhënave mbi gjendjen fizike, gjeologjike, mjedisore dhe sociale të zonës ku parashikohet të zhvillohet projekti. Për mbledhjen e informacionit përdoren teknika të ndryshme që diktohen jo vetëm nga informacioni i kërkuar por edhe periudha në të cilën ky informacion mblidhet, etj.

Pjesë e procesit të deritanishëm të vlerësimit janë edhe studimet mbi gjendjen ekzistuese mjedisore për sezonet e verës, vjeshtës dhe dimrit. Studimi ekologjik për sezonin e pranverës është ende në proces zhvillimi.

Studimi mbi gjendjen ekzistuese të aspektit social është gjithashtu në proces realizimi dhe nuk ka ende një raport përfundimtar.

Sjellim në vëmendjen tuaj se për sa i përket raporteve të cituara nga ana juaj (Raporti i studimit, hidrologjik, sedimentar, sizmiologjik, gjeologjik dhe gjeoteknik) kontraktori është në fazën e hartimit të dokumentacionit dhe për rrjedhojë nuk disponojmë një raport përfundimtar për ta vënë në dispozicion të palëve të interesit.

Në përfundim shprehemi se KESH është e angazhuar maksimalisht jo vetëm në ndjekjen dhe realizimin e projektit në përputhje standardet ndërkombëtare dhe parashikimet ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë, por gjithashtu mbetet maksimalisht e angazhuar në ndërveprimin me komunitetin dhe organet e qeverisjes vendore e qendrore në frymën e transparencës maksimale dhe opinion-marrjes për qëllime të realizimit të një projekti fizibël me ndikim minimal social-mjedisor.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.



ADMINISTRATOR

Ergys VERDHO